



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 08/11/2024

PROCES VERBAL

Konsultimi për Buxhetin dhe Paketën Fiskale 2025

Vendi : Njësia Administrative Çarshovë

Ora : 11:00

Tema e konsultimit : Buxheti dhe Paketa Fiskale 2025.

I mbajtur sot më datë 8 Nëntor me pjesëmarrjen e Kryetares së Bashkisë, znj. Alma Hoxha, Kryetares së Këshillit Bashkiak, znj. Anila Dhimitri, nën/Kryetarit z. Florand Hasani, Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë z. Agathokli Proko dhe Administratorit të njësisë Çarshovë z. Ilia Jani. Gjithashtu pjesëmarrës janë banorë të zonave përreth dhe subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë zonë. Takimi u hap nga znj. Alma Hoxha e cila fillimisht falenderoi të gjithë të pranishmit. Më pas ajo u tha të pranishmëve që këto takime janë mjaft të rëndësishme për të hartuar buxhetin e vitit të ardhshëm.

Më pas fjalën e mori znj. Anila Dhimitri e cila gjithashtu theksoi se këto dëgjesa kanë një rëndësi të madhe në hartimin e Buxhetit të ri si dhe gjithashtu shërbejnë për të njohur edhe më mirë problematikat e zonave në fjalë.

Problematikat e fshatrave u paraqitën nga Kryetarët e tyre si më poshtë :

Fshati Zhepë

1. Rrugët e brëndshme të fshatit me nevojë për ndërhyrje
2. Kanalizimet duhen pastruar
3. Probleme me ujin e pijshëm në stinën e dimrit

Fshati Çarshovë

1. Problemi me vendgrumbullimin e mbetjeve
2. Pastrimi i përroit të fshatit
3. Ndërhyrje në sistemimin e ujërave të zeza
4. Linja e transportit publik Përmet-Çarshovë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

5. Ndërhyrje në rrugën kryesore dhe ato të brendshme të fshatit të cilat janë mjaft të ngushta për të kaluar mjete të mëdha

Fshati Stërmbec

1. Probleme me ujin e rezervuarit të fshatit

Fshati Iliar

1. Rruga kryesore e fshatit kërkon ndërhyrje në disa pjesë të saj
2. Të shikohet mundësia për ndërtimin e një ujësjellësi të ri

Në fund të takimit znj. Alma Hoxha i siguroi banorët se së bashku me stafin e saj do të bëjë maksimumin për të ndërhyrë fillimisht atje ku është më emergjente dhe më pas tek çdo problem në zonën e tyre. Duke i falenderuar edhe një herë për bashkëpunimin e mirë që ekziston mes palëve, znj. Alma Hoxha shprehu gatishmërinë për të zhvilluar takime sa herë të jetë nevoja për diskutim.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:

